

PRILL 2015

Letra

Mileniumi i Tretë

INFORMATIVE

MËSIMI I BAZUAR NË PROJEKTE



NJË JAVË PËRPARIMI E KËNAQËSIE

JAVA E
GJUHËS

KONKURSI I
FOTOGRAFISË

SPELLING
BEE

DITA E
TOKËS

GJATË PRILLIT...

MËSIMI I BAZUAR NË PROJEKTE

NJË JAVË PËRPARIMI E KËNAQËSIE



Java e projekteve u finalizua me prezantimin e hapur në shkollën *Mileniumi i Tretë* të premten e parë të muajit prill. Në hapësirën për shumë qëllime u ekspozuan punimet e një jave, që nga e hëna, ditë kur nisi *Mësimi i Bazuar në Projekte*. Punimet e shfaqura ishin dëshmia më e mirë e punës së mrekullueshme të nxënësve, të cilët falë nxitjes dhe mbështetjes së vazhdueshme të mesimdhënësve dhe gjithë stafit të shkollës tashmë kanë krijuar traditën e të nxënësve përmes kësaj forme mjaft frytdhënëse, si shprehje e një segmenti shumë të rëndësishëm për mesimnxënie.

Qëllimi i kësaj jave ishte që nxënësit përmes hulumtimit, punës kreative, anketimeve, incizimeve, eksperimenteve, artit, vizitave jashtë shkollës etj. të zhvillojnë njohuritë e tyre në fusha të ndryshme.

Temat e ciklit të ulët për klasat II- III

Ritmet e zemrës, Një botë pa paragjykime, Njohim njëri- tjetrin përmes gjuhës, Shoqërohem përmes punës kreative

Temat e ciklit të ulët për klasat IV – V

Unë dhe të tjerët, Diversiteti nëpërmjet, kukullave, Njohim njëri- tjetrin përmes gjuhës, Bota dhe hapësira që na rrethon, Shoqërohem përmes punës kreative

Tema të tilla si: *Simfonia e një qyteti, Dokumentet biometrike, Energjia alternative, Comics, Tourist guide, Zejet e vjetra, Dobitë dhe pasojat e komunikimit në rrjetet sociale, Body language, Punime me argjilë, Rregullimi i hapësirës së shkollës, Graduimi, Koncerti, Fëmijëria ime, e prindërve dhe e gjyshërve* ishin mjaft të larmishme, si mundësi që secili nxënës të gjejë prirjet e tij për të dhënë maksimumin e kreativitetit.

Mrekullia e gjithë prezantimeve ishin të vegjlit tanë, të cilën në formë të shfaqjes me kukulla në formën e një spektakli shfaqën punën e mrekullueshme që bënë për një javë. Gjejmë rastin të falënderojmë gjithë prindërit që kontribuan në shkollë gjatë kësaj jave, sidomos znj. Rudina Bërdynaj për ndihmën e ofruar rreth projektit *Ritmet e zemrës*. Temat e projekteve për ciklin e ulët ishin mjaft atraktive.



Kjo formë e mësimit tashmë është bërë tradicionale. *MBP*-ja organizohet dy herë në vit. Nxënësit e presim me padurim, pasi, përveç punë kreative, për ta është një javë mjaft e këndshme.

Gjithashtu, tash e disa vjet kemi të ftuar nxënës dhe mësimdhënës nga shkolla të ndryshme të Kosovës, si formë e bashkëpunimit efikas. Kësaj here patëm mysafirë 8 nxënës dhe një mësimdhënëse nga *Shkolla e Gjellbër* dhe po ashtu 8 nxënës dhe një mësimdhënëse nga *Shkolla Model*, të dyja këto shkolla të kryeqytetit. Si mësimdhënëset, ashtu edhe nxënësit u shprehën të jenë ndarë shumë të kënaqur nga gjithë kjo ccfarë panë gjatë një jave të tërë. “Je jemi krenarë që sadopak mund të kontribuojmë me ide të tilla edhe në shkollat e tjera të Kosovës”, u shpreh në fund koordinatori i *Mësimi të Bazuar në Projekte*, znj. Fitore Hoxha-Saliu, zv. drejtoreshë e shkollës *Mileniumi i Tretë*.

KUIZI I SHKENCAVE NATYORE, AKTIVITET I SFIDAVE DHE I SUKSESEVE

Me emocione, që vështirë të fshihen, nxënësit fitues dhe përfaqësues klasash po përgatiteshin për garën finale në kuizin e shkencave natyrore në lëndët matematikë, fizikë, kimi, biologji dhe informatikë.



Gara doli të jetë shumë interesante dhe sfiduese për nxënësit, të cilët garuan denjësisht dhe shfaqën dijet e tyre në këto lëndë.




Nxënësit fitues morën medalje dhe certifikata për arritjet e tyre, që janë treguesi më i mirë për njohuritë e tyre dhe përgatitjen për të ardhmen e tyre të ndritshme.



EKSPOZITË PËR FESTAT E MARSIT

Jo gjithërë manifestimet për festa festohen njëjtë. Kësaj here, mësimdhënësit e Gjuhës Shqipe dhe mësuesit e klasave të ulëta, për dy ditë me radhë, në orët e Gjuhës Shqipe kërkuar nga nxënësit që të shkruajnë ese dhe poezi të ilustruara për festat e Marsit.





Nxënësit, me shumë vullnet e dëshirë shfaqën kreativitetin e tyre dhe shpërfaqën shpirtin e tyre artistik dhe ndjesitë për personat më të afërt, mësuesit, prindërit, sidomos nënën për festën e saj, 8 Mars. Ata përkujtuan ngjarjen e lavdishme, Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificën e familjes Jashari.



Orë mësimi në teatrin Oda

Një orë mësimi u realizua në teatrin Oda. Nxënësit mësuan për teatrin dhe skenarin. Idetë e nxënësve do të realizohen në një orë mësimi për temën Shkrimi gazetaresk.





Instrumentistët e vegjël

Duar të vogla por që krijojnë një atmosferë shumë të këndshme në klasën “Dielli”. Dikush me kitarë e dikush me piano po luan melodi të bukura për shokët dhe shoqet e klasës. Këta fëmijë e duan muzikën, artin andaj edhe një pjesë të kohës ia kushtojnë këtyre instrumenteve.



Art Gashi



Enio Skenderi



Rea Qosaj



Hana Perjuci



Urata Reçica




Tiara Mustafa

Java e Gjuhës Shqipe



Në shkollën tonë filloi *Java e Gjuhës Shqipe*. Java nisi më 20 prill me kategorinë *drejtshkrim dhe bukurshkrim*. Të gjithë nxënësit mundoheshin të shkruanin pa gabime drejtshkrimore, ndonëse vetëdija për të shkruar saktë tashmë është ngulitur në mendjen e gjithsecilit nxënës.



Gjatë orëve të mësimit vërehej se si nxënësit e klasës së gjashtë, të shtatë, të tetë dhe të nëntë diskutonin për rregullat e drejtshkrimit në mënyrë që puna e tyre të ishte pa gabime. Gjithashtu të gjithë përpiqeshin të shkruanin sa më bukur! *Java e Gjuhës Shqipe* në shkollën “Mileniumi i Tretë” tashmë është tradicionale.

Aktivitetet në shkollën “Mileniumi i Tretë” realizohen edhe me prindër

Në kuadër të temës “Konventa për të drejtat e fëmijëve” në lëndën edukatë qytetare, sot në shkollën “Mileniumi i Tretë” janë realizuar aktivitete me nxënësit e klasës së VI nga prindi Veton Sylhasi. Falenderojmë prindin në fjalë për kontributin e dhënë.

Aktivitetet e tilla të realizuara nga prindërit janë shumë atraktive dhe të mirëseardhura për nxënësit tanë.



PËRRALLAT E GJYSHËRVE



Kush janë ata që na duan më shumë se prindërit tanë? Kush janë ata që çdo ditë palodhshëm mendojnë dhe kujdesen për ne? Ata të cilët asnjëherë nuk lodhen, nëse kemi dëshirë të këndojmë, kërcëjmë e bërtasim, e për ta kjo është vetëm një lumturi!

Ata janë GJYSHJA & GJYSHI

Gjyshërit janë njerëzit më të këndshëm me të cilët mund të kënaqen edhe fëmijët më të vegjël. Në brishtësinë e duarve të tyre, fshihet një forcë aq e fuqishme saqë është e aftë t'i mbrojë fëmijët më mirë se kushdo tjetër. Ata janë personat që më së shumti ofrojnë ngrohtësi dhe dhurojnë fjalë të ëmbla në mesin familjarë. Këshillat dhe fjalët e tyre nuk harrohen kurrë, mund t'i krahasosh me këshillat e njerëzve më të ditur.



Ata me përrallat dhe anekdotat e tyre vazhdimisht kultivojnë virtytet më të çmueshme dhe fisnike të nipat dhe mbesat e tyre.



Andaj, klasat e dyta ftuan gjyshërit të jenë pjesë e klasës me përralla, anekdota, gjëgjëza, fjalë të urta etj. Fëmijët u gëzuan shumë me praninë e gjyshërve në klasë.

Ky projekt u realizua në muajin shkurt në kuadër të temës mujore “PËRRALLAT E GJYSHËRVE”.

Letra informative



Klasa II/1 falënderon:

- Ymer Bërbatin (gjyshin e Uratës)
- Besa Shkodra (gjyshja e Tiarës)
- Sabrie Shporta (gjyshja e Hanës)
- Besa Shala (gjyshja e Lionit)
- Zyhdi Axhemi (gjyshi i Lekës)
- Silvana Lila (gjyshja e Emirës)



Klasa II/2, falënderon:

- Seniha Vokshi (gjyshja e Lumit)
- Myrvete Disha (gjyshja e Rronit)
- Miradie Arifi (gjyshja e Ernestit)
- Violeta Arifi – Krasniqi (nëna e Ernestit)
- Besa Hoxha (gjyshja e Klarisës dhe Oredës)



Klasa II/3, falënderon:

- Miradie Arifi (gjyshja e Artit)
 - Violeta Arifi – Krasniqi (nëna e Artit)
 - Valdete Ramadani – Humolli (nëna e Melodisë)
 - Bahrije Ymeri (gjyshja e Dasarit)
 - Dafina Ymeri (nëna e Dasarit)
- Lumnije Etemi (gjyshja e Alisë)



Shkolla jonë, testuese e programit ECDL



Prej muajit shkurt në shkollën tonë ka filluar trajnimi profesional i tërë stafit mësimor për *ECDL – European Computer Driving License*, certifikim i njohur ndërkombëtarisht për përdorimin e kompjuterit.

Kohë më parë shkolla jonë është licencuar si Qendër testuese e programeve për ECDL, me 1 mësimdhënës trajner, prandaj edhe trajnimi edhe testimi organizohet në nivel shkolle, ndërsa certifikimi do të bëhet nga ECDL – Kosova.

Po ashtu, me këto programe do të certifikohen edhe të gjithë nxënësit e klasave 9-12 të cilët dëshirojnë të kenë dokument zyrtar certifikues për studime të mëtejshme.

Dhurata për Shtëpinë e Pleqve



Në kuadër të temës mujore” Përrallat e gjyshërve”, si përmbyllje klasat e dyta vizituan Shtëpinë e Pleqve në Prishtinë. Nxënësit së bashku me prindërit e tyre kishin përgatitur dhurata të ndryshme për banorët që jetojnë aty.

Dikush me veshje të ndryshme, dikush me mbathje, tjetri me mjete higjienike, e dikush me lojëra të ndryshme i gëzuan 82 pleqë që jetojnë aty.

Përcjellja e fëmijëve u bë nga mësueset e klasave, punëtorët social si dhe drejtoresha e Shtëpisë së Pleqve.

Njëherit klasat e dyta i falënderojnë të gjithë prindërit që kontribuan me dhurata solide që i gëzuan gjyshërit dhe gjyshet.

TË GJITHË NË NDIHMË TË MIRJETËS!

Nxënësit e shkollës sonë morën një nismë humanitare për ta përkrahur Mirjeta Shalën e cila vuan nga sëmundja e leukemisë. Ata, përveç të hollave, sollën edhe ëmbëlsira dhe gatime të ndryshme, të cilat më pas i shitën në sheshin “Nënë Tereza”. Të gjitha paratë e mbledhura u deponuan në llogarinë e Mirjetës. Nxënësit urojnë që Mirjeta sa më shpejt të gëzojë shëndet të plotë!

Olimpiada

MATEMATIKA

Në Olimpiadën e matematikës të organizuar nga Komuna e Prishtinës, nxënësja e klasës së nëntë, Dea Buleshkaj mori Vendin e Dytë.

Shkolla i uron suksese të mëtutjeshme Deas!



TALENTET E KËNGËS

Në kurorëzimin e javës së projekteve talentet e këngës na kënaqën me zërin e tyre melodioz.

Janë këto Anjeza Sylejmani, Hana Arenliu dhe Klesta Haraqia, të cilat i dhanë ngjyrimin festiv programit të sotëm.



SPORT

TURNEU NË SHKOLLË, NJË NGJARJE QË NGJALL SHUMË EMOCION

Gjatë Javës së Projekteve në shkollën *Mileniumi i Tretë* zhvillohet turneu i futbollit të vogël për djem dhe turneu i basketbollit për vajza. Lojë pas loje për një javë rresht arrihet deri te finalja e cila u mbajt të premten, duke nxjerrë më të mirët e shkollës. Mësimdhënësit e edukatës fizike ndanë kupat për kampionët dhe kështu përmbyllën me sukses këtë javë që për nxënësit mbetet një nga më të pëlqyerat e vitit.



Pinpongu gjithashtu është një garë e nxehtë mes nxënësve të ciklit të ulët. Arsimitarja e edukatës fizike, Edona Cami shprehet të jetë ndarë shumë e kënaqur me nivelin që kanë treguar nxënësit në lojën e zhvilluar para disa dite. Fituesit u shpërblyen me kupa dhe me certifikata.

PRILLI SJELL GËZIM!



1 prilli, dita që në gjithë botën kujtohet si dita e shakave apo gënjeshtreve. Kjo festë me origjinë pagane dikur shënonte ardhjen e pranverës. Në fillesat e krishtërit, shumë njerëz talleshin me ata që ende e festonin këtë datë. Në Australi banorët e Melburnit ishin ata që u bënë të parët viktimë të shakave të kësaj dite. Me t'u gdhirë dita e 1 prillit ata panë se si makinat e tyre ishin mbështjellë me qese plastike. Pas kësaj iu desh që të çlironin makinat për të vazhduar të qetë ditën. Nuk dihet se kush ua punoi rrengun, por ajo që dihet është se shumë prej banorëve e morën këtë veprim me humor.

JAVA E

PROJEKTEVE

Prezantimi

i punës më 3 prill

JAVA E

GJUHËS

SHQIPE

Java e katërt e prillit është e rezervuar për JAVËN E GJUHËS SHQIPE.

SPELLING

BEE

Germëzimi, një tjetër garë që ngjall emocion.

DITA E

TOKËS

Kujdesi për TOKËN, jo vetëm më 22 prill!